



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 108/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Nenad Lazić anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të vendosjes së posterave në objekte dhe në rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

VENDIM

KONSTATOHET tërheqja e ankesës e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ZL. A.nr. 108/2017 të datës 01.10.2017.

Arsyetim

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka paraqitur ankesë në PZAP kundër Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të vendosjes së posterit në rrugë dhe në objekt publik në Rrugën “UÇK” në Gjakovë të kandidatit për Kryetar të Komunës së Gjakovës nga radhët e AAK-së, për Zgjedhjet Lokale 2017.

Me datë 02.10.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë me nr. Protokolli 106/3 për tërheqjen e ankesë me numër: Anr.108/2017 të datës 01.10.2017 me arsyetimin se janë bërë disa gabime gjatë raportimit, e të cilat do të evitoheshin vetëm me tërheqjen e ankesës në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.108/2017 më datën 03.10.2017.

Kryesuese e Panelit
Adnan Konushevci

